



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 23171 / Prot
11

Tiranë, më 11/2/2022

URDHËR

Nr. 29, Datë 1. 2. 2022

**“PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE NË
STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) 17
“KONTRATAT E SIGURIMIT””**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e Sigurimit”.
2. Ndryshimet e SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”, të publikuara në Dhjetor 2021, kanë datë efektive pas 1 Janar 2023.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

MINISTËR

Delina Ibrahimaj

